



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA
KOMANDA MBËSHTETËSE

Nr. 2171 Prot.

Tiranë, më 19.5.2025

Lënda: Kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve për transportin e materialeve zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025.

KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE

Tiranë

Komanda Mbështetëse, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 816, datë 24.04.2025 "Për vënie mjetesh në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për transportin e materialeve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025", në periudhat kohore 25 prill 2025 - 22 maj 2025, ka mbështetur Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, me 217 kamionë transporti (kamion të mbuluar) për transportin e materialeve zgjedhore nga magazinat e KQZ, Lundër, Tiranë për në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjidhor të vendit dhe kutitë e votimit të votuesëve jashtë vendit nga Parku Olimpik për në magazinat e KQZ Vaqarr, Tiranë.

Për realizimin e detyrës sipas urdhrave të Ministrit të Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, lidhën Akt-Marrëveshjen e protokolluar në Komandën Komandës Mbështetëse nr. 1727/1, datë 25.04.2025 dhe nr. prot. të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 3064/1, datë 29.04.2025 "Për vënie mjetesh në dispozicion të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve", dhe në bazë të saj ka realizuar detyrën për shpërndarjen e materialeve zgjedhore, sipas grafikëve dhe destinacioneve të paraqitura nga KQZ.

Nga Komanda Mbështetëse (Batalioni i Transportit), është bërë mbështetja me mjete transporti për transportin e materialeve zgjedhore nëpër qarqe dhe rrethe, si më poshtë;

Në datën 25.04.2025 u angazhuan në detyrë 10 (dhjetë) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Elbasan dhe Durrës.

Në datën 28.04.2025, u angazhuan në detyrë 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Shkodër, Vlorë, Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë.

Në datën 29.04.2025, u angazhuan në detyrë 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Korçë, Fier, Tiranë, Lezhë dhe Berat.

Në datën 30.04.2025, u angazhuan në detyrë 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Tiranë.

Në datën 05.05.2025, u angazhuan në detyrë 28 (njëzet e tetë) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Dibër, Lezhë, Shkodër dhe Gjirokastrë.

Në datën 06.05.2025, u angazhuan në detyrë 34 (tridhjetë e katër) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Vlorë, Kukës, Berat dhe Korçë.

Në datën 07.05.2025, u angazhuan në detyrë 34 (tridhjetë e katër) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Fier, Elbasan.

Në datën 08-09. 5.2025, u angazhuan në detyrë 53 (pesëdhjetë e tre) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Tiranë dhe Durrës.

Në datën 21-22.05.2025, u angazhuan në detyrë 10 (dhjetë) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore në qarkun Tiranë.

I gjithë procesi i transportimit të materialeve zgjedhore është mbikqyrur dhe ndjekur nga përfaqësues të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Për realizimin e detyrës nga Komanda Mbështetëse (sipas përlllogaritjeve të bëra të krahasuara dhe me GPS e mjeteve) për periudhën 25 prill 2025 deri më 22 maj 2025 janë aktivizuar 217 kamionë transporti (kamion të mbuluar) të cilat në total kanë kryer **47,108 kilometra** duke harxhuar një sasi prej **13 686 litra gasoil** me vlerë **2 326 620 lekë**, sasi prej **347 litra vaj lubrifikant** me vlerë **141 576 lekë**, dhe janë angazhuar 162 personel që trajtohen me dietë jashtë rrethit me vlerë **891 000 lekë**.

Vlera totale e shpenzimeve për transportimin e materialeve zgjedhore është **3 359 196 lekë**, e cila sipas akt-marrëveshjeve duhet të rimbursohet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve bazuar në akt-rakordimin e bërë ndërmjet dy palëve (Komanda Mbështetëse dhe KQZ).

Për sa më sipër, bazuar në pikën 2 të akt marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, është detyrim i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, të rimbursojë shpenzimet direkte (vajra lubrifikante, dieta dhe shpenzime të tjera për personelin e angazhuar), sipas argumentimit të shpenzimeve të bërë nga Komanda Mbështetëse në përputhje me konfirmimin e bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe/ose Komisioni Zonal i Administrimit Zgjidhor, të rimbursohet në natyrë sasinë e karburantit që është harxhuar për realizimin e transportit të materialeve **zgjedhore prej 13 686 (trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjet e gjashtë) litra, dhe vlerë, konsumin e vajrave lubrifikante 141 576 lekë, si dhe shpenzime për personelin, 891 000 lekë.**

Bashkëlidhur,

- Tabela me zërat e shpenzime e përlllogaritur nga Komanda Mbështetëse.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

KOMANDANTI

Gjeneralbrigade Aleksandër Pando



KOSTO PERFUNDIMTARE E SHPENZIMEVE FINANCIARE
PER TRANSPORTIMIN DHE SHPERNDARJEN E MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA DEPOT E REZERVAVE
TË SHTETIT, LUNDER, TIRANE PER NE KZAZ NE TE GJITHE TERITORIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE.

Nr.	Emertimi i materialit	Njesia	Cmimi per njesi me TVSH	Sasia	Vlera ne total (lekë)
1	2	3	4	5	6
I	Shpenzime Transporti				2,468,196
1	Gasoil	Litra	170.0	13,686	2,326,620
2	Benzine	Litra	0	0	0
3	Vaj SAE 20*50	Litra	0	0	0
4	Vaj 15*40	Litra	408	347	141,576
II	Shpenzime Personeli				891,000
1	Personel trajtuar me ushqim	Ditë	0	0	0
2	Personel me diete	Ditë	0	0	0
3	Personel me diete	Ditë	0	0	0
4	Personel me diete	Ditë	5,500	162	891,000
5	Ore pune jashte orarit	Ditë	0	0	0
6	Shpenzime udhetimi	Ditë	0	0	0
III	Amortizimi mjetesesh				0
1	Kilometra të përshkruara	km	0	47,108	0
	TOTALI				3,359,196

Shefi i Logjistikës
N/Kolonel Zydi Acani

[Signature]